



UEFA  
**EURO2024**  
GERMANY



# SHQIPËRI - POLONI



**AIR ALBANIA STADIUM**

E DIEL | 10 SHTATOR | ORA 20:45

macron.com



f @ t y



macron

**WHEN  
EVERYTHING  
IS IN YOUR  
HANDS**



**BECOME  
YOUR OWN  
HERO.**



Të dashur miq të futbollit,  
Me ndeshjen kundër Republikës Çeke në stadiumin 'Fortuna Arena' të Pragës, kaluam gjysmën e rrugëtimit tonë të rëndësishëm drejt ëndrrës 'Gjermani 2024'. Kuqezinjtë tanë morën një rezultat pozitiv në sfidën në transfertë ndaj çekëve, që për momentin mbajnë vendin e parë në grupin E. Sigurisht që nëse do të fitonim, të gjithë do të ishim shumë më të lumtur, por pikët e ndara në atë barazim 1-1 vlejnë po aq shumë.

Kemi bërë katër ndeshje. Kemi fituar ndaj Ishujve Faroe e Moldavisë, kemi barazuar me Çekinë dhe kemi humbur ndaj Polonisë. E pikërisht, me këta të fundit do të luajmë sonte 'finalen e pestë' në shtëpinë tonë, 'Air Albania'. Pika ndaj Çekisë nuk duhet të na bëjë euforikë, duhet të jemi me këmbë në tokë sonte, duhet të futemi me besimin për të marrë një tjetër rezultat pozitiv. Polakët kanë një skuadër të fortë, kanë një trajner me emër të madh si Fernando Santos, kanë lojtarë që luajnë në ekipet më të mira në Europë e botë. Vlerësimi i kundërshtarit nuk duhet të mungojë nga ana jonë, ashtu sikurse nuk duhet të mungojë edhe vetëbesimi dhe fryma që ne mund t'ia dalim.

Ama, edhe ne kemi një skuadër kompakte. Vërtetë nuk janë më të mirët në botë, por për ne janë YJE. Kemi çdo repart të plotësuar, një përzierje mes lojtarësh me eksperiencë dhe futbollistësh të rinj në moshë, të cilët japin edhe shpirtin në fushën e lojës për këtë Kombëtare. Profesionalistë me P të madhe! Secili prej tyre përpiqet të japë gjithmonë më shumë se 100% nga vetja kur u besohet një vend

në skuadër nga trajneri Silvinjo. Jam i bindur që do ta bëjnë edhe sonte ndaj Polonisë. Na mungojnë dy futbollistët tanë, Marash Kumbulla e Armando Broja, të cilëve u uroj rikthim sa më të shpejtë në skuadër. E sa mirë edhe për trajnerin Silvinjo dhe stafin e tij, të cilët mund të zgjedhin mes më të mirëve.

Është e vërtetë që tashmë pritshmëritë e të gjithëve ne janë rritur, por nuk duhet të marrim asgjë si të mirëqenë. Duhet të luajmë fort. Duhet të luajmë me zemër, të sakrifikojmë në fushën e lojës. Duhet të tregojmë se kemi gjak shqiptari, gjak luftëtari, gjak njerëzish që nuk dorëzohen kurrë. 11 do të jenë ata, 11 do të jemi edhe ne. Për fat të mirë, luajmë në stadiumin tonë dhe me mbi 20 mijë tifozët që do të jenë të pranishëm në stadium, ne do të jemi 12! Koret e tyre duhet t'i këndojmë së bashku. Duhet t'i dëgjojmë së bashku. Duhet të frymëzohemi së bashku. Duhet të fitojmë së bashku. Ishim në Pragë me mijëra, jemi në Tiranë sërish me mijëra.

Pavarësisht se skuadra nuk ka pasur shumë ditë në dispozicion për t'u stërvitur së bashku, trajneri Silvinjo dhe stafi i tij kanë ditur si t'i frymëzojnë çunat tanë. Jam mëse i sigurt që kuqezinjtë tanë do të luajnë ashtu sikurse duhet dhe se do të tregojnë se nuk janë rastësisht në vendin e dytë. Me një rezultat pozitiv do të na tregojnë se me shumë mundësi nuk do të jenë as rastësisht në finalët e kampionatit European të vitit të ardhshëm!

Forca çuna! Të gjithë jemi me sy e zemër nga ju! Na tregoni sa vleni, na falni emocione të mëdha! Tregoni se jeni shqiptarë! Na kanë mbetur ende edhe katër finale drejt 'Gjermani 2024'. Ju mundeni!

Miqësisht,  
Armand Duka

# Mbrojtja më e mirë për makinën tuaj.

Siguroni automjetin tuaj me Kasko, i cili  
përballet me rreziqe sa herë që lëvizni në  
rrugë apo qëndroni në parking.

Sigurimi  
KASKO  
i makinës  
vetëm tek  
SIGAL  
UNIQA



S

Sylvio Mendes Campos Junior, pasi e ka bërë "vijë" krahun në fushën e blertë, po tenton të lërë shenjë si trajner. Ai nuk u është trembur ndonjëherë sfidave, as kur u bë braziliani i parë që veshi

fanellën e Arsenalit në vitin 1999, as kur pranoi të drejtonte Shqipërinë me synimin për ta çuar në Kampionatin Europian "Gjermani 2024". Si futbollist, Sylvinho, ka provuar të fitojë, që kur ishte pjesë e Corinthians. Kampion në Brazil, më pas tre herë kampion edhe në Spanjë me Barcelonën. 49-vjeçari ka fituar me katalanasit edhe dy herë trofeun më të rëndësishëm për klube, UEFA Champions League. Një karrierë e pasur mes kampionësh si futbollist.

Sylvinho është munduar t'i bëjë hapat e vegjël, duke ia nisur si ndihmëstrajner i Cruzeiro në vitin 2011, pak muaj pasi kishte lënë futbollin e luajtur. Stacionet e radhës ishin Sport Recife dhe Nautico, para se të rikthehej te Corinthians si ndihmës i Tite. Në dhjetor të vitit 2014, trajneri aktual i Shqipërisë pranoi ftesën e Roberto Mancin-it për të qenë pjesë e stafit të tij tek Interi. Në korrik të vitit 2016 Silvinjo iu bashkua Brazilit, sërish krah Tite. Rreth tre vite te "Seleção" dhe më

pas momenti për të provuar eksperiencën e parë si "dirigjenti" kryesor në stafin teknik. Francezët e Lyon ia besuan stolin për disa muaj. Eksperiencë për Sylvinhon, që më pas u rikthye sërish në Brazil. Këtë herë për ta drejtuar Corinthians nga maji i vitit 2021, deri në shkurt të vitit pasardhës. Koha për pak pushim dhe më pas Shqipëria.

Epoka e re si shqiptarë e Sylvinhos nisi me humbje, në Varshavë, por fryma që ka sjellë në Kombëtare ndihet. Pothuajse çdo ditë braziliani është në zyrë së bashku me ndihmësit e tij, Zabaleta e Dorivas, duke punuar për ndeshjen e radhës. Fluturime të shumta për të takuar futbollistët kuqezi dhe për t'u prezantuar projektin e tij. Besim i dhënë për ta dhe shpërblim i marrë me fitoret kundër Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Në këto 9 muaj ka edhe lojtarë të fituar, si Jasir Asani, ndërkohë që për herë të parë me Kombëtaren janë bashkuar edhe Mirlind Daku dhe Arbnor Muja.


Sylvinho e di shumë mirë që duhet eksperiencë dhe talent për të ecur përpara, si dhe motivimi i duhur. Ai po përpaket t'ia japë këtë Shqipërisë, që të vazhdojë të ëndërrojë kualifikimin për të dytë herë në një Kampionat Europian. E do për vete, e do për tifozët shqiptarë që nuk e kanë zhgënjyer, duke e mbështetur në Poloni, në "Air Albania" ndaj Moldavisë dhe në Ishujt Faroe. Ata nuk munguan as në Pragë, kurse sot ndaj Polonisë e mbushën sërish follenë kuqezi. Koha për betejën e radhës...



**FEDERATA  
SHQIPTARE E  
FUTBOLLIT**



**SYLVIO  
MENDES  
CAMPOS  
JUNIOR**



# RRUGËTIMI DREJT EURO 2024

## POLONIA SI SHANS PËR PËRSËRITUR HISTORINË!

**S**hqipëria do të përballlet të dielën me Poloninë në stadiumin "Air Albania" në duelin më vendimtar të kualifikueseve të Europianit "Gjermani 2024". Një ndeshje që mund të vendosë fatet e kombëtares kuqezi që synon të arrijë në finale të turneut më të rëndësishëm kontinental për të dytën herë në historinë e vet.

Shqipëria aktualisht renditet e dyta në Grupin E të kualifikueseve me 7 pikë të grumbulluara në 4 ndeshjes, vetëm një pikë pas kryesuesve të Republikës Çeke dhe plotësisht në garë për të kaluar në finale të turneut madhor.

Nisja e kësaj fushate në muajin mars nuk ishte më e mira, pasi Shqipëria, e drejtuar tashmë nga braziliani i mirënjohur Sylvio Mendes Campos Junior, u mund në transfertë polake me rezultatin 1-0. Një rezultat duhet thënë i padrejtë, pasi Kombëtarja shqiptare bëri një paraqitje shumë të mirë, duke e vënë në vështirësi Poloninë e yjeve edhe në shtëpinë e tyre. Një performancë që u prit mirë edhe nga tifozët që kishin besim të madh qysh në fillim se kjo skuadër mund t'i bëjë

të ëndërrojnë. Sepse misioni sapo kishte nisur dhe pavarësisht humbje, skuadra kishte dhënë sinjale pozitive dhe siç thotë edhe trajneri Sylvinho, llogaritë duhen bërë në xhiron e fundit.

Dhe kjo u konfirmuar pikërisht ndaj Moldavisë, duelit të dytë që u luajt në qershor në shtëpinë e shqiptarëve, stadiumin "Air Albania". Në ditën e fundit biletat u shitën të gjitha dhe kuqezinj-të zbritën në fushë me tribunat e mbushura plot e përplot me spektatorë.

Me një vendosje ofensive në fushë, trajneri Sylvinho drejtoi ekipin drejt një suksesi të madh. Dy gola të shkëlqyer të shënuar nga Jasir Asani dhe Nedim Bajrami, që fiksojnë rezultatin në shifrat 2-0, i dhanë 3 pikët e merituar Shqipërisë në një atmosferë fantastike dhe një festë të vërtetë në Tiranë.

Tre ditë më pas ishte radha e një transferte të gjatë, asaj të Ishujve Faroe. Sërish vendosje taktike ofensive, sërish një interpretim i mirë i kuqezinjve në fushë dhe Kombëtarja shqiptare arrin të kthehet në shtëpi me maksimumin e mundshëm. Në fillim i zakonshmi Nedim Bajrami zhbllokon rezultatin pas disa rasteve të mira për gol, por vendasit barazojnë pa u mbyllur pjesa e parë. Për të zgjidhur ngërçin mendon Kristijan Asllani në pjesën e dytë, i cili realizon një nga golat më të bukur të kualifikueseve deri më tani sipas UEFA-s, njësoj si në rastin e Jasir Asanit.



Për t'u theksuar se edhe kryevepra e tij ndaj Moldavisë i cilësua si goli më i bukur i asaj xhiroje. Dhe për të vulosur gjithçka mendon Ernest Muçi, njëriun që e bën golin të duket sikur është gjëja më e thjeshtë në botë. I futur në fushë gjatë pjesës së dytë sulmuesi i talentuar shfrytëzon maksimalisht një rast në zonë, duke e dërguar topin në rrjetë me një të majtë vrastare. Rezultati 3-1 dhe tre pikët i shkonë Shqipërisë që tashmë me 6 pikë renditet e dyta në grup. Ndërkohë, një lajm i mirë vjen nga Moldavia, aty ku vendasit në mënyrë të pabesueshme arrijnë të përmbysin disavantazhin 2-0 ndaj Polonisë për të fituar 3-2.

Pas pushimeve të verës, Kombëtarja u ribashkua në fillim të shtatorit me një kalendar mjaft të ngjeshur dhe me kohën e pakët në dispozicion, ku çdo minutë ka vlerë të madhe dhe mund të rezultojë vendimtar. Në vetëm dy ditë trajneri Sylvinho dhe stafit të tij teknik i duhej të përgatishnin dy finalët e kualifikueseve ndaj Republikës Çeke në transfertë dhe Polonisë në shtëpi. Prova e parë e zjarrit rezultoi pikërisht ashtu siç të gjithë e kishin parashikuar. Në stadiumin "Fortuna Arena" të Pragës përballë Republikës Çeke, një skuadër me shtatllartësi të theksuar në çdo repart të fushës, kuqezinjtë bënë një ndeshje mjaft të mirë. 90 minuta plot me sakrificë, vuajtje, strategji për të bllokuar pikat e forta të kundërshtarit dhe me një disiplinë të fortë taktike, Shqipëria arrin të arrë një pikë të artë që e mban skuadrën në garë për t'u kualifikuar. Një pikë që erdhi falë atij realizimi fantastik të Nedim Bajramit në pjesën e dytë që lëdhon një predhë nga jashtë zone për të befasuar portierin dhe Çekinë. Një gol që shokoi të gjitha stadiumin, aty ku dëgjoheshin vetëm tifozët kuqezinj, më të shumtë se kurrë në numër në një transfertë. Përveç tifozëve vendas, trullosjen e pësoi edhe Çekia që humb toruan dhe në minutat e fundit mund të ishte ndëshkuar sërish nga kuqezinjtë, këtë herë vërtetë të pafat para portës.

Pas ndeshjes së Pragës, nuk kishte kohë për festë me Kombëtaren që nisi menjëherë përgatitjet për "finalen" e radhës atë ndaj Polonisë, që ndërkohë mundi me vështirësi Ishujt Faroe pak ditë më parë në Varshavë. Në një kohë që biletat për ndeshjen si rrallëherë kanë përfunduar prej më shumë se 20 ditësh dhe stadiumi do të jetë "full", atmosfera në ekip është shumë pozitive dhe gjendja fizike apo edhe psikologjike është e mirë. Trajneri së bashku me ndihmësit e tij Zabaleta, Doriva, Bulku, por edhe pjesën tjetër të stafit, kanë punuar pa pushim për të përgatitur në detaje këtë ndeshje, që mund të përcaktojë shumëçka në objektivat e Shqipërisë për shkuar në finalët e Europianit. Në rast fitoreje Shqipëria do të konsolidonte bindshëm pozitat e saj në grup dhe njëkohësisht mund të nxjerrë nga gara atë që ishte edhe rivali më i fortë në startin e kualifikueseve. Ironia e fatit: dy vjet më parë Shqipëria luante shanset për të shkuar në play-offin e finaleve të Botërorit Katar 2022 pikërisht ndaj Polonisë në "Air Albania". Një fitore do të shkruante historinë kuqezi, por për fat të keq ëndrrat e shqiptarëve përfunduan pas asaj humbje të pamerituar 0-1.

Dhe tani është koha për shpagim me Shqipërinë që ka një mundësi mjaft të mirë të "hakmerret" dhe t'i vërtetojë të gjithëve se tashmë ka një kombëtare që përballlet si e barabartë, pa kurrfarë droje edhe me ekipet më të mëdha të Europës.

Kombëtarja është shumë pranë përsëritjes së historisë për të shkuar për të dytën herë në finalët e një Europianit, pas atij të 2016-s në Francë.



*#gjithmonëmeKompëtaren*



unionbank.al



+355 4 238 9111

E krijuar për aventurë.



E lindur në natyrë.



## STAFI TEKNIK I KOMBËTARES A





Kombinimi perfekt  
ku fitojnë të gjithë



Vodafone  
**GIGA FAMILY**

**2x**

- GB me planet Next+
- Shpejtësi Interneti Fiks
- Paketa televizive në Vodafone TV

**Ready?**



**vodafone**

# SHQIPËRIA





ODISE  
**ROSHI**



MIRLIND  
**DAKU**



MYRTO  
**UZUNI**



YLBER  
**RAMADANI**



NEDIM  
**BAJRAMI**



ARB NOR  
**MUJA**



SOKOL  
**CIKALLESHI**



KEIDI  
**BARE**



KRISTJAN  
**ASLLANI**



JASIR  
**ASANI**



QAZIM  
**LAÇI**



KLAUS  
**GJASULA**



ERNEST  
**MUÇI**



TAULANT  
**SEFERI**



**#EQUAL GAME**

 **RESPECT**



**Your journey  
continues  
through  
INFINITY**

## OUR SERVICES



Infinity Destinations (DMC) is a professional services organization that specializes in planning, organizing and managing various aspects of travel and events in a given destination.



We have detailed knowledge of the local area, including attractions, accommodations, transportation options, cultural nuances and logistical considerations.



We work closely with our clients to understand their goals, preferences and budget constraints, and then use our local knowledge and connections to design and deliver personalized experiences.

## CONTACT US

## OUR HISTORY



Infinity Destinations was founded in 2013, offering exceptional customer service and customized travel packages. Over the years, the agency expanded its offerings to include adventure tourism, luxury cruises and cultural tourism.

## OUR VISION



To be a leading service provider in travel management solutions- an entrepreneurial, innovative and inspiring company of choice for employees, customers, partners and shareholders.

## OUR MISSION




We will demonstrate a return of investment to our customers and suppliers. We will empower our teams to make the best decisions for our customers. Our shareholders will be at the forefront of our business growth strategy.



# **POLONIA**







***Everything you need,  
plus the style and extras  
you love !***



@makalbaniahotel



= 355 4227 4707



= 355 69 603 2575



reservations.tirana@makalbania.com



## FEDERATA POLAKE E FUTBOLLIT

|                         |                                                     |
|-------------------------|-----------------------------------------------------|
| President               | Cezary Kulesza                                      |
| Sekretar i Përgjithshëm | Łukasz Wachowski                                    |
| Themeluar më            | 20 Dhjetor 1919                                     |
| Anëtarësimi në UEFA     | 20 Prill 1923                                       |
| Anëtarësimi në FIFA     | 2 Mars 1955                                         |
| Adresa                  | ul. Bitwy Warszawskiej 1920<br>r. 7 02-366 Warszawa |
| Telefon                 | 732 122 222                                         |
| Website                 | <a href="http://www.pzpn.pl">www.pzpn.pl</a>        |
| E-mail                  | <a href="mailto:pzpn@pzpn.pl">pzpn@pzpn.pl</a>      |



SHQIPËRI-POLONI

# NJË HISTORI E VËRTETË FUTBOLLI

» NGA TRITAN KOKONA

**H**istoria e ballafaqimeve mes Shqipërisë dhe Polonisë është një histori e hershme, mbushur me ngjarje, emocione, befasi, gëzime e zhgënjime, një histori e vërtetë futbolli. Dy vendet që simbol kombëtar kanë shqiptarët (polakët të bardhën me një kokë, ndërsa shqiptarët të zezën me dy koka), në historinë e tyre kanë disa gjëra të përbashkëta. Janë kombe luftarakë, që për shekuj me radhë e kanë përshkruar rrugën e historisë duke luftuar. Të dyja provuan pushtimet në luftën e fundit botërore. Pas përfundimit të saj, në të dyja vendet u vendos sistemi diktatorial komunist, si në të gjithë Europën Lindore. Shumë të rinj shqiptarë gjatë kësaj periudhe, janë shkolluar në Universitetet Polake, ndërkohë që marrëdhëniet tregtare me Poloninë, kanë qenë ndër më intensivet për kohën.

Pas rënies së komunizmit, sidomos pas viteve 2000, polakët kanë qenë turistët e parë që “zbuluan” Shqipërinë dhe vazhdojnë ta zgjedhin atë si destinacionin e tyre të pushimeve.

Historia e ballafaqimeve futbolistike, ka nisur plot 74 vjet më parë, kur Kombëtarja shqiptare e drejtuar nga Sllave Llambi do të humbiste në stadiumin “Legia” të Varshavës 2-1. Një start ballafaqimesh, që brenda kornizave të një ndeshjeje miqësore, pati dramaticitetin e vet. Kjo sepse Shqipëria, pësoi golin që i shkaktoi humbjen, në minutën e fundit të ndeshjes. Një paralajmërim se këto ndeshje do të krijonin historinë e tyre, që në 74 vjet vazhdon të prodhojë përsëri emocione të jashtëzakonshme. Golin e parë në këto ballafaqime e ka shënuar më 6 nëntor 1949 polaku Cieslik. Edhe golin e fundit e ka shënuar përsëri një polak, Sëiderski më 27 mars të këtij viti. Shqiptari i parë që ka shënuar në portën polake ka qenë mjeshtri Zihni Gjinali me 11-metërs në ndeshjen e parë. Të fundit Sokol Cikalleshi, në barazimin e përkohshëm në 2 shtatorin e vitit 2021. Në 12 ndeshjet e zhvilluara deri më tani, Shqipëria ka arritur që të fitojë vetëm një herë



**POLONI - SHQIPËRI**

6.11.49 - Varshavë - Stadiumi Legia - 60000

**Gjyqtar:** Nemcovski (Çekosllovak) - Miqësore**Shënues:** 9' Ceslik, 55' Gjinali (Il m), 90' Kohut  
**Polonia:** Borucz, Gedelek, Parpan, Barwinski, Suzyzyck, Wierczorek, Hogendorf, Baran (Kohut), SWicarz, Cieslik, Wisniewski (Mordarski)**Shqipëria:** Vogli, B.Boriçi, Llambi, Spahiu, Shaqiri (Jareci), Kavaja, Parapani, Gjinali, Boriçi, Teliti, Biçaku. Tr. S. Llambi**2-1 (1-0)****SHQIPËRI - POLONI**

1.5.50 - Tiranë - Stadiumi "Q. Stafa" - 20000

**Gjyqtar:** Danko (Hungari) - Miqësore**Shqipëria:** Bonati, Dibra, Vathi, Spahiu, B.Boriçi, Shaqiri, Kavaja, Parapani, Gjinali, Boriçi, Biçaku, Mirashi. Tr. B. Jakova  
**Polonia:** Juroviç, Bavinski, Vieskorek, Gendek, Suskiç, Slomaj, Kohut, Graç, Ajnova, Cilik, Wianiewski.**0-0 (0-0)****SHQIPËRI - POLONI**

29.11.53 - Tiranë - Stadiumi "Q. Stafa" - 20.000

**Gjyqtar:** Dorogi (Hungari) - Miqësore**Shënuesit:** 12' Boriçi, 35' Resmja**Shqipëria:** - Vogli, Dashi, Fagu, Dibra, Shaqiri, Vila, Bakalli, Jareci, Boriçi, Resmja, Deda. Tr. M. Vdash**Polonia:** Shimkoviak, Genlek, Bartila, Durnjak, Vieçorek (Kander), Bjenjek, Gronovski, Trembish, Alsher, Krasufka, Sobek**2-0 (2-0)****POLONI - SHQIPËRI**

14.10.70 - Katowicë - Stadiumi "Sloski"

**Gjyqtar:** Fouriades (Qipro) - Kampionati Evropian**Shënues:** 17' Gadosha, 84' Lubanski, 94' Szysik**Polonia:** Czaja, Stachurski, Gorgon, Wiborek, Musia, Szotysik, Bula, Marks, Deyna, Lubanski, Gadocha**Shqipëria:** Dinella, Frashëri, Dhales, Kasmi, Cani, Shilaku, Çeço, rragami, Bizi, Pano, Zhaga. Tr. L. Boriçi**3-0 (1-0)****SHQIPËRI - POLONI**

12.5.71 - Tiranë - Stadiumi "Q. Stafa" - 20000

**Gjyqtar:** Helies (Francë) - Kampionati Evropian**Shënues:** 7' Banash, 31' Zhaga**Shqipëria:** Dinella, Gjika, Dhales, Cani, Kasmi, Rragami, Vaso (Berisha), Bizi, Çeço, Pano, Zhaga. Tr. L. Boriçi**Poloni:** Grotinskji, Vrazh, Winkler, Ancok, Virbek, Blaut, Shutishek, Deyna (Cmikeviç), Banash, Lubanski, Gadocha (Kozerski)**1-1 (1-1)****POLONI - SHQIPËRI**

31.10.84 - Mielec - Stadiumi Stal - 25000

**Gjyqtar:** Galer (Zvicër) - Kupa e Botës**Shënues:** 23' Smolarek, 54' Omuri, 76' Kola, 79' Palasz**Poloni:** Kazamierski, Kubicki, Zmuda, Wojcicki, Vodovij, Buncol (Komornicki), Boniek, Matysik, Xhekanovski, Palasz, Smolarek**Shqipëria:** Musta, Ragami, Targaj, Hodaj, Omuri, Ballgjini (Lame), Eksarko, Demollari, Josa, Muça, Minga, Kola. Tr. Sh. Rreli**2-2 (1-0)****SHQIPËRI - POLONI**

30.5.85 - Tiranë - "Q. Stafa" - 25000

**Gjyqtar:** Zhezhov (Bullgari) - Kupa e Botës**Shënues:** 24' Boniek**Shqipëria:** Musta, Zmijani, Hodja, Targaj, Omuri, Jera, Muça (Mile), Demollari, (Marko), Josa, Minga, Kola. Tr. Sh. Rreli**Polonia:** Mlinarçik, Pavlak, Vojcinka, Pshevesh, Ostrovski, Matçik, Bunkol, Urban (Tarasoviç), Xhekanovski, Boniek, Smolarek**0-1 (0-1)****POLONI - SHQIPËRI**

19.10.88 - Katowicë, "Stadiumi Shlonski" - 30000

**Gjyqtar:** Salarnir (Rumani) - Kampionati Evropian**Shënues:** 78' Varzushak**Polonia:** Vandezik, Varzusha, Vojciki, Lukashik, Vdovçik, Matushik (Ziober), Rudi, Urban, Smolarek, Furtok, Varzushka (Kubik)**Shqipëria:** Mersini, Alimehmeti, Lekbello, Hodja, Jera, Josa, Gega, Demollari, Millo, Shehu (Stoja), Minga. Tr. Sh. Rreli**1-0 (0-0)****SHQIPËRI - POLONI**

15.11.89 - Tiranë - "Q. Stafa" - 9000

**Gjyqtar:** Smith (Skoci) - Kupa e Botës**Shënues:** 45' Taraskievic, 69' kushta, 85' Ziober**Shqipëria:** Nallbani, Zmijani, Hodja, Xhumba, Iljadhi, Josa (Arbëri), Demollari, Jera, Pano (Kepa), Kushta, Bubeqi. Tr. Sh. Rreli**Polonia:** Bako, Kubicki, Kashmarek, Shahovski, R. Varzusha, Taraskievic, Shevçik, Vdovçik, Xhekanovski (K. Varzusha).**1-2 (0-1)****POLONI - SHQIPËRI**

02.09.2021 Varshavë - "Narodowy" - 38 254

**Gjyqtar:** Maurizio Mariani (Itali) - Kualifikueset e Kupës së Botës 2022**Shënues:** 12' Lewandowski, 44' Buksa, 54' Krychowiak, 89' Linetty / 25' Cikalleshi**Polonia:** Szczesny, Bereszynski (Dawidowicz 33'), Glik, Bednarek, Rybus (Puchacz 81'), Jozwiak, Moder, Krychowiak, Kumbowski (Linetty 62'), Lewandowski, Buksa (Swiderski 81'), Tr. P. Sousa**Shqipëria:** Berisha, Hysaj, Ismajli, Kumbulla, Gjimshtiti, Trashi (Roshi 67'), Gjasula, Abrashi (Çekiçi 74'), Bare, Manaj (Balaj 68'), Cikalleshi (Uzuni 83'). Tr. E. Reja**4-1 (2-1)****SHQIPËRI - POLONI**

12.10.2021 - Tiranë - "Air Albania" - 21 000

**Gjyqtar:** Clement Turpin (Francë) - Kualifikueset e Kupës së Botës 2022**Shënues:** 77' Swiderski**Shqipëria:** Berisha, Hysaj, Ismajli, Kumbulla, Veseli, Trashi (Lenjani 65'), Bare (Çokaj 77'), Ramadani, Roshi (Bajrami 77'), Uzuni (Broja 58'), Manaj. Tr. E. Reja**Polonia:** Szczesny, Glik, Bednarek (Helik 90+3'), Dawidowicz, Puchacz (Bereszynski 90+1'), Krychowiak, Zielinski, Jozwiak (Frankowski 71'), Moder (Klich 46'), Lewandowski, Buksa (Swiderski 71'). Tr. P. Sousa**0-1 (0-0)****POLONI - SHQIPËRI**

27.03.2023 - Varshavë - "Narodowy" - 56 227

**Gjyqtar:** Sillavko Vincic (Slloveni) - Kualifikueset e Euro 2024**Shënues:** 41' Swiderski**Shqipëria:** Strakosha, Balliu, Kumbulla, Mihaj, Hysaj, Gjasula (Laci 88'), Ramadani, Asllani (Bajrami 75'), Asani (Mehmeti 70'), Uzuni, Cikalleshi (Seferi 75'), Tr. Sylvinho**Polonia:** Szczesny, Salamon, Bednarek, Kiwior, Zielinski, Linetty (D. Szymanski 78'), Frankowski, Zalewski (Skoras 68'), Kaminski, Lewandowski, Swiderski (S. Szymanski 89'). Tr. F. Santos**1-0 (1-0)**

më 29 nëntorin e vitit 1953. Tre ndeshje janë mbyllur në barazim. Ndërsa Polonia ka fituar tetë herë, duke shënuar 19 gola në portën e Shqipërisë ndaj vetëm 7 golave të shënuara nga shqiptarët.

Por historia ka rezervuar edhe shumë të papritura dhe ngjarje, të cilat mbahen mend gjatë nga opinionioni futbolldashës i Shqipërisë. Në eliminatoret e Botërorit “Meksikë ‘86” Kombëtarja gjendej në të njëjtin grup me Belgjikën, Poloninë dhe Greqinë. Ndeshja e dytë në grup luhej në Mielec të Polonisë, e cila konsiderohej favorite e grupit, së bashku me Belgjikën. Në gjirin e kësaj skuadre kishte talente të mëdhenj të kalibrit europian si Boniek, Smolarek, Buncol, Xhekanovski etj. Por Shqipëria tregohet shumë entuziaste dhe jo vetëm barazoi por edhe kaloi në avantazh pas dy golave të shënuar nga Omuri dhe Kola. Ndeshja përfundoi në barazim 2-2 dhe u shoqërua nga një fitore magjike kundër Belgjikës në ndeshjen pasardhëse. Me katër pikë, Shqipëria ishte në “qiellin e shtatë”. Kombëtarja kishte një pozicion tepër të favorshëm në grup ndërsa tifozët ëndërronin që për herë të parë, të merrnin pjesë në një kompeticion madhështor si Botërori.

Për këtë arsye, ndeshja e 31 majit 1985, ishte më shumë se e rëndësishme. Ajo mund të vendoste për fatin e një kualifikimi historik. Në mesditë, në aeroportin e Rinasit zbriste një avion i vogël charter direkt e nga Brukseli. Ylli i Polonisë Zbigniew Boniek, i shpallur vetëm përpara 12 orësh Kampion i Europës me Juventusin, pas një ndeshjeje historike kundër Liverpulit, kishte mbërritur në Tiranë për t'i dhënë “një dorë” Polonisë së tij, në këtë takim vendimtar. Njeriu që mori penalltinë e fitores, të kthyer në gol nga Platini, vendosi edhe fatin e ndeshjes me Shqipërinë. Në të vetmen mundësi të krijuar në minutën e 24-të të takimit, ai gjeti një qoshe të largët të portës së mbrojtur nga Musta dhe e çoi topin në rrjetë, duke zvetënuar të gjitha rastet e humbura të Shqipërisë. Ëndrra më e madhe për kualifikim u pre në mes. Por i tillë është futboll...

Së fundmi për eliminatoret e Kupës së Botës “Katar 2022”, Kombëtarja në atë kohë e drejtuar nga Edi Reja ka arritur të jetë konkurrenente e Polonisë, duke shpresuar deri në ndeshjen e fundit me ta, të zhvilluar në Tiranë. Por përsëri, ishte Polonia ajo që fitoi dhe ja “vrau” kombëtares ëndrën, për të siguruar vendin e dytë. Dhe përsëri edhe këtë herë është Polonia, rivale në grupin eliminator. Përsëri jemi përballë në këtë, kryqëzim shumë të rëndësishëm eliminator. Për të vazhduar historinë tonë. Një histori futbollit dhe ballafaqimesh që vazhdon prej 74 vjetësh.

# Global Travel Company



VAS GROUP is a business group, which under its umbrella are a group of companies operating in the travel and tourism sector. Each company is a standalone brand by itself, depending on the type of services they provide in their respective markets. For years, VAS GROUP has been inspiring

the travel & tourism community by offering the most exclusive destinations at client's reach. The group is always engaged in innovating travel experiences and tailoring new services to widen the options for the business partners of each of its companies operating under VAS GROUP's name.

📍 ALBANIA AUSTRIA BOSNIA&HERZEGOVINA TURKEY KOSOVA UAE SLOVENIA





## ZYRTARËT E NDESHJES SHQIPËRI - POLONI

| ROLI              | EMËR / MBIEMËR               | KOMBËSIA |
|-------------------|------------------------------|----------|
| Arbitër           | José María Sánchez Martínez  | Spanjë   |
| Asistent i parë   | Raúl Cabañero Martínez       | Spanjë   |
| Asistent i dytë   | Íñigo Prieto López de Cerain | Spanjë   |
| Arbitër i katërt  | Guillermo Cuadra Fernández   | Spanjë   |
| VAR               | Carlos del Cerro Grande      | Spanjë   |
| Asistent VAR      | Cesar Soto Grado             | Spanjë   |
| Vëzhgues i UEFA-s | Robert Sedlacek              | Austri   |
| Delegat i UEFA-s  | Danilo Filacchione           | Itali    |

# #EQUAL GAME



## RESPECT



Vodafone  
**GIGATV**



# Një spektakël i madh sportiv

Merr **DigitAlb Premium** ose **Tring Sport**  
në çdo dyqan Vodafone dhe shijo  
emocionet e ndeshjeve të **Serie A**.

Together we can

